



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHITIME/ OPSTINA-STIMLJE/ MUNICIPALITY OF SHITIME
ZYRA E KRYETARIT/KANCELARIJA PREDSEDNIKA/MAYOR'S OFFICE

Datë: 26.06.2025

Nr. prot: 02/ 694

Në mbështetje të neneve 53 dhe 57 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, sipas neneve 4 dhe 5 të Ligjit nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, si dhe në pajtim me nenin 10 të Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM

1. Themelohen ekipi i veprimit për implementimin e rekomandimeve nga Raporti i Auditimit 2024 për Pasqyrat Financiare nga Zyra Kombëtare e Auditimit për Komunën e Shtimes.
2. Ekipi i implementimit të rekomandimeve nga Raporti i Auditimit formohet në këtë përbërje:
 1. Bujar Ferati – Kryesues
 2. Kimete Ukaj – anëtare
 3. Minire Halili – anëtare
 4. Besnik Ahmeti – anëtar
 5. Frosina Berisha-Ahmeti – anëtar
 6. Grejtalb Emini – anëtar
 7. Valon Januzi – anëtar
 8. Bardhyl Rushiti – anëtar
 9. Gojart Bajrami – anëtar
 10. Merita Emini – anëtare

11. Albana Fazliu – anëtare
 12. Lulzim Sahiti – anëtar
 13. Lulzim Muharremi – anëtar
 14. Jetush Rrafshi – anëtar
3. Ekipi vepron në pajtim me detyrimet ligjore të përcaktuara sipas Ligjit nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike dhe Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, për të përmbushur rekomandimet e dhëna nga Raporti i Auditimit për Komunën e Shtimes për vitin 2024.
4. Konkretisht, detyrat e ekipit përfshijnë:
1. Pranimin e Planit të Veprimit të dorëzuar në ZKA për implementimin e rekomandimeve;
 2. Hartimin e veprimeve konkrete për implementimin të rekomandimeve;
 3. Monitorimin e plotë të nivelit të përmbushjes së rekomandimeve;
 4. Raportimi te Kryetari për procesin e implementimit të rekomandimeve;
 5. Hartimin e Raportit për Ministrinë e Financave dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit sipas nenit 14 të Rregullores nga ZKA (dy herë në vit, deri më 30 shtator dhe 15 mars).
5. Përmes këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi nr. 02/710 i datës 28.06.2024.
6. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Iu dërgohet:
ZKA
Anëtarëve
Arkivit



Kryetari Komunes

Qendri Aliu